




INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

TË DREJTAT E FËMIJËS





Jeta është një udhëtim i përbashkët i njerëzve.

Që ky udhëtim të jetë sa më i bukur, duhet të respektojmë të drejtat e njëri tjetrit.

Edhe të rriturit, edhe fëmijët duhet ta bëjnë këtë.



Një vajzë a djalë



që është më pak se 18 vjeç, konsiderohet fëmijë.

Jeta, mirëqenia, si dhe zhvillimi intelektual, social dhe emocional varet nga kujdesi dhe edukimi që fëmija merr në familje dhe në rrethin ku jeton.

**Fëmija që rritet në ambient që i do dhe i mbështet,
do të ketë më shumë vetëbesim dhe vetëvlerësim.**

**Ka një varg të drejtash të cilat janë specifike për fëmijët e të cilat janë të radhitura
në një dokument shumë të rëndësishëm,
i miratuar më 1989,
i emërtuar**

KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS,

Zbatimin e kësaj Konvente e monitoron

Komiteti i të Drejtave të Fëmijëve.

KONVENTA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

ka 54 nene, të cilat mbështeten në:

Të drejtën për të jetuar, për t'u mbrojtur e për t'u zhvilluar

Të drejtën për emër, etni dhe shtetësi

Të drejtën për përkujdesjen më të mirë

Të drejtën për mosdiskriminim

Të drejtën për arsim, të bazuar në mundësi të barabarta

Të drejtën e privatësisë

Të drejtën që të kenë qasje në informacion dhe të mbrohen nga informacioni që i dëmton

Të drejtën për mbrojtje të veçantë nga të gjitha format e abuzimit dhe të keqtrajtimit

Të drejtën për pushim dhe aktivitete të lira

Fëmijët kanë të garantuara edhe :

Lirinë e mendimit

*Fëmijët kanë të drejtë të japin mendimin për çdo gjë që lidhet me ta.
Mendimi i tyre duhet të merret parasysh*

Lirinë e shprehjes

*Fëmijët gëzojnë të drejtën të shprehin lirshëm dhe të kërkonjnë, marrin dhe shpërndajnë
informacion*

Lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë

Lirinë e shoqërimit dhe pjesëmarrjes

Fëmijët kanë të drejtë të shoqërohen dhe të marrin pjesë në takime.

Liria juaj është deri aty ku fillojnë të drejtat e tjetrit.

**Ju duhet të respektoni të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe nuk duhet të jeni kërcënim
për shoqërinë ose veten tuaj.**

PSE FËMIJËT DUHET TË DIJNË PËR TË DREJTAT E TYRE?

Që të kuptojnë çka janë të drejtat;

Që të kenë të qartë se të drejtat u takojnë të gjithëve;

Se të drejtat e të tjerëve duhen respektuar,ashtu siç kërkojmë që të tjerët;

të respektojnë të drejtat tona;

Se respektimi i të drejtave fillon nga familja;

Se të drejtat janë gjithashtu edhe përgjegjësi.

PËRGJEGJËSITË E SHTETIT PËR FËMIJËT

Shteti ka obligim dhe përgjegjësi të mbrojtë të drejtat dhe liritë e secilit fëmijë

Shteti duhet të ofroj përkujdesjen dhe shërbimet e duhura për ata fëmijë që janë pa familje

Shteti duhet të sigurojë që sistemi i drejtësisë t'i përgjigjet të drejtave dhe nevojave specifike të fëmijëve

NËSE FËMIJËT MENDOJNË SE U JANË CENUAR TË DREJTAT

Mund të flasim me persona të besuar, të tillë si prindërit, mësuesit, mjekët, punonjësit socialë shokët, ose persona që mund të kujdesen për ju;

Policia është një adresë ku fëmijët mund të kërkojnë mbrojtje nga shteti;

**Avokati i Popullit është një nga institucionet e shtetit, ku fëmijët mund të drejtohen,
nëse u cenohen të drejtat e tyre**

CILA ËSHTË PËRGJEGJËSIA E AVOKATIT TË POPULLIT?

Të dëgjoj me kujdes ankesën e fëmijës për cenim apo shkelje të të drejtave apo lirive.

T'i ruaj në mirëbesim të dhënat nga ankuesi/ja dhe t'i trajtojë ato me paanësi e profesionalizëm.

Të hetojë pohimet për shkelje të të drejtave dhe lirive dhe të angazhohet për zgjidhjen e tyre.

T'u drejtohet autoriteteve përgjegjëse me raporte dhe rekomandime për rastet e trajtuara.

Avokati i Popullit gjithashtu i bën të njohura të drejtat dhe liritë e njeriut, i promovon dhe i përkrah ato përmes informimit, edukimit dhe me anë të mediave

Për ta takuar Avokatin e Popullit, ju mund të drejtoheni në adresën:

**Institucioni i Avokatit të Popullit
Lagjja Bregu i Diellit, Rr. “Enver Maloku”, nr. 28
10000 Prishtinë, KOSOVË**

Ju gjithashtu mund t’i shkruani në adresën elektronike:

info@ombudspersonkosovo.org

**Kur keni ndonjë shqetësim për të cilin doni ta njoftoni Avokatin e Popullit,
ju mund të telefononi falas në numrin**

0800 15555